

# Kryetari i rajonit Normandi e poshtme Laurent Beauvais do të zhvillojë vizitë në Shkup



---

BASSE-NORMANDIE MACÉDOINE

---

**Kryetari i rajonit Normandi e poshtme, Z. Laurent Beauvais, do të zhvillojë vizitë në Shkup me 7 dhe 8 qershor 2009 në kuadër të programit për bashkëpunim të decentralizuar që e lidh Maqedoninë me Normandinë e poshtme.**

Ambasada e Francës në Shkup

KOMUNIKATË PËR SHTYP



Kryetari i rajonit Normandi e poshtme, Z. Laurent Beauvais, do të zhvillojë vizitë në Shkup me 7 dhe 8 qershor 2009 në kuadër të programit për bashkëpunim të decentralizuar që e lidh Maqedoninë me Normandinë e poshtme.

**Bashkëpunimi Maqedoni/Normandi e poshtme**, që ka mobilizuar 700.000 € gjatë periudhës 2007/2009 me konkurimin e Ministrisë për punë të jashtme të Francës, përkrah diku 30-të partnerë franko-maqedonas në fushat e rinisë, arsimit, qytetërimit europian, informacionit dhe mediave, kulturës, trashëgimisë dhe turizmit të qëndrueshëm. Ajo mbështetet mbi angazhimin e njësisve teritoriale, institucioneve publike, institucioneve shkollore dhe shoqatave që në të dy shtetet kontribuojnë për zhvillim lokal dhe këmbime në mes dy vendeve.

Pjesëmarrja e të përzgjedhurve lokal në tërësinë e aksioneve të bashkëpunimit u ilustrua kohëve të fundit me qëndrimin në Normandi të poshtme nga 22 deri më 26 qershor të kryetarëve të këtyre komunave Ohër, Resnjë, Strugë, Vevçan, Dibër, Tetovë dhe kryetares të këshillit komunal të Berovës.

**Gjatë vizitës së tij në Shkup, kryetari Beauvais do të takoj:**

- ▶ Ministrin për vetqeverisje lokale, Z. Xhaferi për të arritur një marrëveshje të përgjithsme e cila do t i jap kuadër dhe bazë institucionale tërësisë së aksioneve dhe partneriteteve,
- ▶ Kryetarin e BNJVL, Z. Trajanovski, për të hapur një fushë këmbimesh dhe bashkuar përpjekjet dhe eksperimentat,
- ▶ Zëvendës ministrin e kulturës, Z. Nedeljkovik, për të përgatitur festivalin pranveror balkanik që do t i përkushtohet Maqedonisë në vitin 2010 dhe 10 vitet e programit të valorizimit të trashëgimisë që ka të bëjë me qytetet e vjetra (çarshitë) e qyteteve të Shkupit, Manastirit dhe Velesit,
- ▶ Përfaqësues të delegacionit europian, për të siguruar një bashkëpunim inovues për qëllimet e integritit europian të vendit.

**Takimi i punës së 7 korrikut në mes Ministrit Xhaferi dhe kryetarit Beauvais** do të merret me bilancin e programit për bashkëpunim të decentralizuar, perspektivat e reja të punës që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale dhe modalitetet e marrëveshjes me Shoqatën e agjencioneve të demokracisë lokale (ALDA) që siguron menaxhimin administrativ dhe financiar të programit. Marrëveshja për bashkëpunim, që është në shqyrtim mund të nënshkruhet në vjeshtë të vitit 2009.

**Takimi i punës së 8 korrikut në mes kryetarit të BNJVL, Z. Trajanovski dhe kryetarit Beauvais** do të përfshijë edhe kryetarët e komunave Ohër, Resnjë, Strugë, Vevçan, Dibër, Berovë, Tetovë dhe kryetares të këshillit komunal të Aerodromit që kanë marrë pjesë në qëndrimin e organizuar në Kaen kryeqytetin e Normandisë së poshtme nga 22 deri më 26 qershor si dhe Shoqata e agjencioneve të demokracisë lokale (ALDA), që siguron menaxhimin administrativ dhe financiar të programit. Qëllimi i këtij takimi është të hapë bashkëpunimin në mes BNJVL dhe Normandisë së poshtme dhe të vë angazhimin e rajonit francez në shërbim të sfidave të demokracisë dhe zhvillimit lokal që janë ato të komunave.